



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 18 (827822)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 maj 2023

SHSHP, gjeneral brigade Arben Kingji: Mirënjohje për përkushtimin dhe bashkëpunimin, në shërbim të qëllimit dhe misionit të përbashkët

Të nderuar ushtarake dhe civilë të Forcave të Armatosura, më 4 maj 2023 shënohet 110 - vjetori i krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Themeluesit e shtetit të parë shqiptar ndërtuan institucionet themelore jetike të këtij shteti, përfshirë dhe forcën ushtarake të vendit. Më 4 maj 1913, drejtuesit e kësaj force ushtarake, ngritën dhe organizuan Shtabin Madhor, atë që sot është Shtabi i Përgjithshëm. Sigurisht

që krijimi i Shtabit të Përgjithshëm ishte një domosdoshmëri e kohës, por njëkohësisht ai përbënte një ngjarje madhore në historinë e re ushtarake të Shqipërisë së pavarur. Pas 110 vjetësh, kjo datë vjen si një moment i komunikimit me historinë dhe traditën tonë ushtarake. Vlerësojmë kontributet dhe vlerat e institucionit më të lartë ushtarak të Forcave të Armatosura. Gjithashtu, sot është rasti për të shprehur nderimin dhe respektin për të gjithë

brezat dhe protagonistët, që kanë shërbyer, punuar dhe drejtuar këtë strukturë eprore ushtarake. Data të tilla janë pika reference për të parë dhe vlerësuar rrugën që kemi përshkruar, për të nxjerrë mësimë në funksion të rritjes dhe përmirësimit të rolit dhe funksionimit tonë efektiv. Krahas drejtimit, koordinimit dhe kontrollit të aktivitetit të përditshëm të përgatitjes, gatishmërisë dhe veprimtarisë operacionale... >> faqe 2



5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Kombit Shqiptar



>> faqe 3

Gjeneral brigade Kingji: Shqipëria do të angazhohet dhe do të kontribuojë në mbrojtje të sigurisë kolektive të zonës Euro-Atlantike

Shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, organizoi një takim me koordinorët kombëtarë të shteteve anëtare në Komandën e Aleancës për Transformim të NATO-s (ACT), kjo në kuadër të vizitës së tyre njohëse në vendin tonë. Mes të tjerash gjeneral brigade Kingji tha: Shqipëria gjithmonë do të angazhohet në mbrojtje të sigurisë kolektive të zonës Euro-Atlantike dhe do të jetë kontribuuese për paqen dhe sigurinë rajonale e më gjerë. Gjithashtu gjeneral...



>> Faqe 2

Shqipëria merr pjesë si anëtare me të drejta të plota në Asamblenë e Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë

Shqipëria është ulur si anëtarja më e re, me të drejta të plota në Asamblenë e Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë. Në ceremoninë e hapjes, ku i pranishëm ishte edhe Lartësia e Tij, Alberti II, princ i Monakos, u bë edhe prezantimi i flamurit shqiptar nga ana e komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra. Shqipëria u anëtarësua në Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (International Hydrographic Organization - IHO) një vit më parë, pas shumë viteve...



>> Faqe 4

Forca Ajrore, 72 vjet histori sukcesi shkruar me germa të arta

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ceremonia e 72-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Në aktivitet ishin të pranishëm, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, përfaqësues të Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë...



>> Faqe 5

SHSHP, gjeneral brigade Arben Kingji: Mirënjohje për përkushtimin dhe bashkëpunimin, në shërbim të qëllimit dhe misionit të përbashkët

Të nderuar ushtarake dhe civilë të Forcave të Armatosura, më 4 maj 2023 shënohet 110 - vjetori i krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Themeluesit e shtetit të parë shqiptar ndërtauan institucionet themelore jetike të këtij shteti, përfshirë dhe forcën ushtarake të vendit. Më 4 maj 1913, drejtuesit e kësaj force ushtarake, ngritën dhe organizuan Shtabin Madhor, atë që sot është Shtabi i Përgjithshëm. Sigurisht që krijimi i Shtabit të Përgjithshëm ishte një domosdoshmëri e kohës, por njëkohësisht ai përbënte një ngjarje madhore në historinë e re ushtarake të Shqipërisë së pavarur.

Pas 110 vjetësh, kjo datë vjen si një moment i komunikimit me historinë dhe traditën tonë ushtarake. Vlerësojmë kontributet dhe vlerat e institucionit më të lartë ushtarak të Forcave të Armatosura.

Gjithashtu, sot është rasti për të shprehur nderimin dhe respektin për të gjithë brezat dhe protagonistët, që kanë shërbyer, punuar dhe drejtuar këtë strukturë eprore ushtarake.

Data të tilla janë pika reference për të parë dhe vlerësuar rrugën që kemi përshkruar, për të nxjerrë mësim në funksion të rritjes dhe përmirësimit të rolit dhe funksionimit tonë efektiv.

Krahas drejtimit, koordinimit dhe kontrollit të aktivitetit të përditshëm të përgatitjes, gatishmërisë dhe veprimtarisë operative të FA-së, rendësi të veçantë ka dhe menaxhimi i proceseve të reformimit, ristikurimit dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura në përputhje me realitetet e reja politike, ekonomike dhe sociale të vendit.

Efektivi i sotëm i Forcave të Armatosura ka nevojë t'i njohë vlerat dhe kontributet e Shtabit të Përgjithshëm, të krijuar e realizuar në breza dhe t'i vlerësojë ato, sepse aty janë themelet dhe baza e drejtimit të forcës ushtarake aktuale dhe të ardhme, që ne punojmë dhe përipiqemi çdo ditë ta ndërtojmë, zhvillojmë dhe modernizojmë së bashku.

Në rrjedhën mbi shekullore, Shtabi i Përgjithshëm, ka gdhendur portretet



dhe profilet e tij, ku secili me veçoritë, aftësitë dhe tiparet e ndryshme të kohës dhe rrethanave historike, dallon për veprimtarinë e vet specifike ushtarake, profesionale dhe patriotike. Mirënjohje dhe falënderim për të gjithë ish-drejtuesit e Shtabit të Përgjithshëm, të udhëhequr nga etika e lartë profesionale dhe njerëzore që kanë lënë gjurmë të thella në historinë e këtij institucioni.

Kjo ditë, sot, na bën të kuptojmë sa është rritur Shtabi i Përgjithshëm për 110 vite dhe sa e nevojshme dhe e rëndësishme është për Forcat e Armatosura forcimi i këtij organi

qendror të planifikimit, organizimit dhe drejtimit të përgatitjes profesionale dhe operative të saj. Shtabi i Përgjithshëm ka të gjitha kapacitetet cilësore dhe sasiore për drejtimin dhe menaxhimin e aktivitetit të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit.

Sigurisht që Shtabi i Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të misionit të tij ka patur vazhdimisht mbështetjen dhe bashkëpunimin e plotë dhe të ngushtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe komandave kryesore të të gjitha niveleve e organizmave të tjerë të strukturës tonë ushtarake. Kjo është

një dëshmi e kohezionit tonë të fortë institucional dhe ushtarak, ku edhe Shtabi i Përgjithshëm ka rolin dhe kontributin e tij.

Mirënjohje për përkushtimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin pa rezerva në shërbim të qëllimit dhe misionit të përbashkët!

Sot gjej rastin të falënderoj në veçanti personelin ushtarak dhe civil të Shtabit të Përgjithshëm, që me punën, përkushtimin, përgjegjësinë dhe profesionalizmin e tyre, më kanë mbështetur, ndihmuar dhe lehtësuar në detyrën e Shefit të Shtabit të

Përgjithshëm, në përbushjen e përgjegjësisë të mia për zhvillimin, drejtimin dhe koordinimin e gjithë aktivitetit të Forcave të Armatosura në plotësim të detyrimeve të brendshme dhe euroatlantike.

Një falënderim shkon edhe për shumë institucione civile kombëtare dhe lokale për bashkëpunimin, marrëdhënien dhe mirëkuptimin e shprehur me Shtabin e Përgjithshëm në angazhimet e përbashkëta për kryerjen e detyrave dhe shërbimeve të ndryshme ndaj vendit.

Me anëtarësimin në NATO, kërkesat, intensiteti, diversiteti i punës dhe funksionimit të Shtabit të Përgjithshëm ka qenë gjithnjë e në rritje, me qëllim arritjen e standardizimit dhe ndërveprueshmërisë me konceptet dhe metodologjikën bashkëkohore të mënyrës së funksionimit të vetë Aleancës.

Krahas rolit dhe përgjegjësisë tipike tradicionale ushtarake, duhet të menaxhojë që nga ndërhyrjet dhe operacionet e emergjencave civile, deri tek angazhimet tona ushtarake në misione jashtë vendit duke u bërë edhe një aktor dhe faktor i diplomacisë ushtarake.

Kam bindjen time të palëkundur se me angazhimin dhe përkushtimin për detyrën, Shtabi i Përgjithshëm do të jetë në lartësinë e kërkesave në rritje të kohës, duke merituar kurdoherë dhe plotësisht respektin dhe besimin e autoriteteve civile dhe të të gjithë efektivit të Forcave të Armatosura.

Është rasti i këtij përvjetori, që me mirënjohjen dhe respektin më të thellë për shërbimin, sakrificat dhe kontributin dinjitoz të të gjithë atyre që kanë shërbyer dhe shërbejnë në këtë institucion, t'ju uroj gëzuar përvjetorin e 110-të të Shtabit të Përgjithshëm!

Gjeneral brigade Kingji: Shqipëria do të angazhohet dhe do të kontribuojë në mbrojtje të sigurisë kolektive të zonës Euro-Atlantike



Shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, organizoi një takim me koordinatorët kombëtarë të shteteve anëtare në Komandën e Aleancës për Transformim të NATO-s (ACT), kjo në kuadër të vizitës së tyre njohëse në vendin tonë. Mes të tjerash gjeneral brigade Kingji tha: Shqipëria gjithmonë do të angazhohet në mbrojtje të sigurisë kolektive të zonës Euro-Atlantike dhe do të jetë kontribuuese për paqen dhe sigurinë rajonale e më gjerë. Gjithashtu gjeneral brigade Kingji vlerësoi rolin dhe përgjegjësinë e ACT-së për transformimin e Aleancës, si shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme.



5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Kombit Shqiptar

Dita e Dëshmorëve u vendos të jetë 5 Maji 1942, dita kur u vra nga fashistët, Qemal Stafa, aktivist i Luftës Nacional Çlirimtare. Për të kujtuar këtë pjesë të lavdishme të historisë të kombit shqiptar.

Krerët e shtetit janë mbledhur për të vendosur kurora me lule përpara memorialit "Nëna Shqipëri", në nderim të të rënëve në luftën antifashiste.

Kryeministri i vendit z. Edi Rama, i shoqëruar nga kryetarja e Parlamentit znj. Lindita Nikolla, zëvendësministri i Mbrojtjes Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, kryetari i bashkisë së Tiranës Erjon Veliaj, përfaqësues të veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare dhe familjarë të dëshmorëve, u përkulën me mirënjohje para veprës së dëshmorëve të atdheut.

Përpara krijimit të shtetit shqiptar, bijtë dhe bijat e rënë për liri populli i kujtonte dhe i mbante gjallë legjendat e tyre, nëpërmes këngës epike, dhe trashëgimisë të historisë të tyre nga brezi në brez.

Gjatë luftës Nacional Çlirimtare, fillojnë përpjekjet e para për të nderuar dëshmorët e rënë në fushat e betejave. Të rënë u bënë simbol frymëzimi për luftëtarët e lirisë.

Në Ditën e Dëshmorëve të Kombit janë të shumtë emrat e të gjitha kohërave që kujtohen me mirënjohje, jo vetëm për vlerat e përgjeshme dhe kontributin që dhanë për çlirimin e vendit për një të ardhme më të mirë, por edhe të gjithë ata që sakrifikuan jetën e tyre për liri, demokraci, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari.

LAVDI DËSHMORËVE TË ATDHEUT!

I PËRJETSHËM KUJTIMI I BIJVE DHE BIJAVE MË TË MIRË TË KOMBIT SHQIPTAR!



Shqipëria merr pjesë si anëtare me të drejta të plota në Asamblenë e Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë

Shqipëria është ulur si anëtarja më e re, me të drejta të plota në Asamblenë e Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë. Në ceremoninë e hapjes, ku i pranishëm ishte edhe Lartësia e Tij, Alberti II, princ i Monakos, u bë edhe prezantimi i flamurit shqiptar nga ana e komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra.

Shqipëria u anëtarësua në Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (International Hydrographic Organization - IHO) një vit më parë, pas shumë viteve pune të vazhdueshme. Anëtarësimi me të drejta të plota është i rëndësishëm në njohjen ndërkombëtare të cilësisë së sigurisë së lundrimit në hapësirën detare të Shqipërisë, duke dhënë një kontribut edhe në rritjen e trafikut detar në ujërat tona.

Tashmë hartat detare të prodhuara nga Shërbimi Hidrografik shqiptar njihen zyrtarisht për cilësinë dhe standardet e tyre ashtu si edhe ato të vendeve të tjera anëtare të IHO.

Në takimin e Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë mori pjesë edhe ambasadori i Shqipërisë në Francë z. Dritan Tola dhe konsulli i nderit në Monako z. Giuseppe Durazzo.



Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm viziton Republikën e Kosovës

Në vijim të programit akademik, Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, vizitoi Republikën e Kosovës.

Ditën e parë u zhvillua vizita në Koshare, ku u analizua beteja e zhvilluar në këtë rajon, organizimi dhe vendosja e forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe atyre të kundërshtarit, mënyra e zhvillimit të betejave, prezantimi i këtyre ngjarjeve u realizua nga përfaqësuesit e FSK-së në kursin e KKSHP, major Deme Maloku e Muhamet Thaçi. Më pas stafi akademik dhe kursantët e KKSHP-së vizituan Shtabin e Përgjithshëm, ku u pritën nga drejtori i Drejtorisë së Operacioneve, kolonel Astrit Haliti, i cili i uroi mirëseardhjen dhe me anë të prezantimit i njohu pjesëmarrësit e kursit me misionin, detyrat dhe sfidat e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në komandën e Forcës Tokësore, kursantët u pritën nga komandanti i kësaj force, gjeneral brigade Hysen Dreshaj dhe komandanti i Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë, nënkolonel Ali Krasniqi, të cilët i vlerësuan për vijimin e kursit dhe më pas i njohën me misionin, detyrat, strukturën dhe sfidat për të ardhmen.

Më pas stafi dhe kursantët vizituan Memorialin e familjes Jashari në Prekaz, ku u pritën nga z. Rifat Jashari.

Pjesë e programit ishte dhe vizita në Koman-



dën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj dhe vendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pjesëmarrësit adresuan pyetje për çështje të caktuara, duke zgjeruar njohuritë për funksionimin e institucioneve të mbrojtjes në Republikën e Kosovës.

Specialistët EOD, pjesë e stërvitjes shumëkombëshe "Combined Resolve XVIII", në Hohenfels, Gjermani

Nga data 24 prill - 16 maj 2023, një skuadër EOD e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse merr pjesë në stërvitjen shumëkombëshe të koduar "Combined Resolve XVIII", që po zhvillohet në bazën ushtarake të NATO-s në Hohenfels, Gjermani.

Në këtë stërvitje skuadra EOD ka demonstruar aftësitë e përgatitjes së saj në disa skenarë të veprimit EOD si kontrolli i një pakoje të dyshuar IED dhe çaktivizimin e saj, duke përdorur aparat X-ray, robot etj. Stërvitja vazhdon.



Përfundon në gjithë vendin operacioni i kontrollit të ish - poligoneve të asgjësimit të municioneve

Batalioni i Xhenios realizoi me sukses kontrollin e ish - poligoneve të asgjësimit të municioneve nga mbetjet që mund të kenë mbetur ndër vite.

Operacionet u kryen në poligonet e asgjësimit në Voskopojë, Elbasan, Librazhd, Burrel, Pukë, Bizë, Berat, Skrapar, Tepelenë dhe Këlcyrë. Këto operacione u kryen nga 25 specialistë EOD, të cilët me kontroll vizual dhe me pajisje minakërkuese mundën të kontrollonin një sipërfaqe prej 210 000 m² dhe të evidentonin rreth 55 elementë municionesh të lëna në terren.

Pas përfundimit të kontrollit në të gjitha poligonet u bë vendosja e shiritit kufizues si edhe tabelave sinjalizuese në pika hyrëse të poligonit dhe në sipërfaqe të ngritura të dukshme të terrenit. Operacioni përfundoi me sukses.



FAj, 72 vjet histori sukcesi shkruar me gërma të arta

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ceremonia e 72-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Në aktivitet ishin të pranishëm, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, përfaqësues të Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë, Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Aviacionit, pilotë, teknikë, instruktorë si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore.

Në fjalën e rastit, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, pasi i uroi mirëseardhjen të ftuarve, kujtoi 24 prillin e vitit 1951 si datën kur Arma e Aviacionit Shqiptar hodhi hapin e parë të saj, armë e cila ndër vite ka pësuar transformim, modernizim dhe përsosje të teknologjisë, duke theksuar se vit pas viti Forca Ajrore e gjen veten më të kualifikuar dhe më të trajnuar, më të modernizuar teknikisht e më të aftë profesionalisht, aftësi jetike për ruajtjen e vitalitetit të kësaj force dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit. Komandanti i Forcës Ajrore kujtoi me respekt brezat e komandantëve, pilotëve, teknikëve, inxhinierëve dhe punonjësve civilë, të cilët me pasion dhe përkushtim i shërbyen Aviacionit Ushtarak Shqiptar, duke e bërë atë një armë të dashur për të gjithë, ndërsa kujtoi Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak, të cilët sot janë nderi dhe krenaria e Forcës Ajrore.

Në emër të shoqatës së Aviacionit Ushtarak Shqiptar përshëndeti gjeneral



brigade Astrit Jaupi. Në përshëndetjen e tij shprehu falënderimet dhe mirënjohjen për të gjithë ushtarakët dhe punonjësit civilë të Forcës Ajrore, duke theksuar

se: "Historia e Aviacionit Ushtarak ka shkruar me gërma të arta, punën, kontributin dhe sakrificat deri në ato sublime të gjeneratave të tëra të

komandantëve, pilotëve, teknikëve, personelit inxhiniero-teknik dhe atij mbështetës, civil dhe ushtarak, të cilët shërbyen me përkushtim e dashuri

në përmbushjen e misionit të Forcës Ajrore." Aktiviteti u mbyll me një foto të përbashkët dhe një takim me veteranët e Aviacionit Ushtarak.

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen zhvillon vizitë mësimore në Bruksel

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen në vijim të programit akademik zhvilloi vizitë mësimore në Mbretërinë e Belgjikës.

Stafi akademik pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë me pjesëmarrësit e kursit KLSM - 13, vizituan Komandën Strategjike të Aleancës për Operacionet SHAPE - HQ ACO (Supreme Headquarters Allied Powers Europe - Allied Command Operations) Mons, Selinë e NATO-s, si dhe Shtabin Ushtarak të BE-së.

Qëllimi i vizitës ishte njohja e pjesëmarrësve të KLSM - 13 me institucionet ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, misionin, rolin, dhe detyrat e Komandës Strategjike të Aleancës për Operacionet (ACO), sfidat e transformimit dhe adoptimit me strukturën e re, operacionet aktuale të NATO-s, partneritetet ushtarake dhe prioritetet kyçe të saj si dhe me rolin, koordinimet, operacionet aktuale në botë të EUMS (The European Union Military Staff).

Gjatë ditës së parë të vizitës, KLSM-13 u shoqërua nga gjeneral brigade Petrit Çuni, përfaqësues ushtarak kombëtar i Shqipërisë në ACO, SHAPE, i cili i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve të kursit dhe më pas i shoqëroi për gjatë takimeve me përfaqësues të lartë të drejtorive të SHAPE, të cilët me anë të prezantimeve i njohën kursantët me strukturën aktuale të NATO-s, kontributin e saj në KFOR, kërcënimet hibride dhe kibernetike, zhvillimet e fundit në SHAPE (ACO dhe ACT), sferën e bashkëpunimeve me partnerët si dhe sfidat në të ardhmen.



Në vijim të ditës së dytë, KLSM - 13 vizitoi Shtabin e NATO-s në Bruksel, ku u prit nga ambasadori i

Shqipërisë në NATO z. Visho Ajazi Lika dhe nga përfaqësuesi ushtarak në NATO, gjeneral brigade Ilir Pujo, të

cilët i uruan mirëseardhjen kursantëve dhe i njohën me rolin dhe kontributin e Shqipërisë në operacionet e NATO-s



dhe me gjerë, më pas përfaqësues të Divizionit të Politikave Hibride dhe Kibernetike, Politikave të Sigurisë si dhe Diplomacisë Publike bënë nga një prezantim të punës së tyre. Pjesëmarrësit u njohën mbi situatën aktuale të sigurisë kibernetike, bashkëpunimet etj.

Gjatë sesionit të pasdites, stafi drejtues dhe anëtarët e KLSM - 13 vizituan zyrën e stafit ushtarak të Bashkimit Evropian, ku u pritën nga gjeneralmajor Gábor Horváth, zëvendës drejtor i Përgjithshëm i EUMS, i cili i përgëzoi pjesëmarrësit për ndjekjen e kursit dhe i njohu me situatën e përgjithshme të sigurisë, operacionet aktuale të BE-së dhe ato të planëzuara në të ardhmen.

Më pas pjesëmarrësit u njohën nga zëvendës drejtori i drejtorisë EEAS, kolonel Essel me organizimin, vendimet kryesore përgjatë viteve, detyrat strategjike të EUMS, strukturën e menaxhimit të krizave, sfidat e reja si dhe me kontributin e përfaqësive ushtarake në EU. Vizita në Mbretërinë e Belgjikës e përmbushi në mënyrë të plotë qëllimin e saj akademik dhe kulturor, Pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen treguan mjaft interes dhe adresuan pyetje mbi çështje të caktuara të sigurisë dhe mbrojtjes gjatë të gjitha takimeve zyrtare, duke u njohur akoma më shumë me zhvillimet e fundit të situatës së sigurisë dhe mbrojtjes në vendet e NATO-s, me rolin e institucioneve të rëndësishme si dhe me sfidat dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Në kuadër të programit të shkëmbimit të studentëve ndërmjet Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Akademisë ushtarake të 'West Point', studentët e vitit II Bachelor, Gentila Boçari dhe Rigers Veizi, në programin Shkenca Ushtarake, zhvilluan një vizitë në Akademinë Ushtarake 'West Point', SHBA.

Ky është një program që përfshin një numër të madh shtetesh për SHBA-të ndërsa për Akademinë e Forcave të Armatosura ky program aplikohet me Akademinë e 'West Point-it', Akademinë Ushtarake në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut.

Qëllimi i vizitës ishte për të parë nga afër mënyrën e organizimit dhe funksionimit të jetës studentore gjatë procesit akademik dhe pas përfundimit të tij. Gjatë vizitës së tyre, studentët shqiptarë u pritën nga dy studentë të vitit të katërt të kësaj akademie, të cilët në muajin shkurt kaluan 10 ditë në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Ditët e vizitës u shoqëruan me pjesëmarrje në procesin akademik si dhe vizita në vende të njohura dhe historike në afërsi të Akademisë.

Studentët e vlerësuan pozitivisht vizitën si një përvojë të pa harrueshme dhe sollën nga andej rekomandime të vlefshme, të cilat do të merren në konsideratë nga ana e drejtuesve të AFA-së për të arritur qëllimin tonë për ta përafuar akademinë tonë sa më shumë me atë të 'West Point-it'.

Studentët e AFA-së, vizitë në Akademinë Ushtarake 'West Point'



Foreign Academy Exchange Program 2023



Efektivët e Policisë Ushtarake dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë dhe njerëzit në nevojë

Në Ambientet e Policisë Ushtarake, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, u dhuroa gjak për fëmijët talasemikë dhe njerëzit në nevojë, duke iu bashkuar nismës së dhurimit vullnetar të gjakut me moton "DHURO GJAK, SHPËTO JETË".

Me anë të këtij kontributi efektivat e Policisë Ushtarake solidarizohen me përpjekjet e gjithë atyre të sëmurëve që luftojnë për jetën.

PËRVOJË QË DUHET NDARË

Në sallën 'Aleks Buda' të Akademisë së Shkencave, u zhvillua një aktivitet i organizuar nga Shoqata e Veteranëve të Boksit shqiptar, dalë një pjesë e tyre nga fidanishtja 'Skënderbegase'. Në këtë aktivitet merrnin pjesë ish-sportistë të boksit shqiptar si dhe të sporteve të tjera në vend, por edhe dashamirës të sportit dhe pedagogë nga Universiteti i Sporteve në Tiranë.

Shoqata e organizoi këtë aktivitet për promovimin e tre librave: "Historia e Boksit Shqiptar" (Vëllimi i 4), me autorë z. Et'hem Ibrahimini dhe dy librat e tjerë të titulluar "Arbitri i ringut" dhe "Fjalori i Boksit anglisht - shqip", dy këta të fundit me autor z. Jani Nano.

Botimi i tre librave të rinj, që i shtohen arkivit të sportit të boksit, është një ngjarje që meriton t'i kushtohet vëmendje, jo vetëm nga sporti i boksit, por nga i gjithë komuniteti i sportit në Shqipëri; pasi botimi i këtyre librave shënon një rast të rrallë në vend, sepse boksi është i vetmi sport, për të cilin është shkruar më tepër literaturë në këto 20 vitet e fundit, siç e dëshmojnë edhe këto botime.

Aktiviteti u hap nga ish-komentatori sportiv, z. Bashkim Mërtiri. Ai në fjalën e tij vlerësoi lart botimet z. Et'hem Ibrahimini, President i Shoqatës, i cili ka botuar 4 vëllime kushtuar historisë të boksit në Shqipëri. Në vëllimin e parë ai ka trajtuar fillimet e boksit shqiptar në vitet 20 të shekullit të kaluar e deri në vitin 1963, vit që përkon edhe me ndalimin e këtij sporti në vendin tonë. Në vëllimin e dytë ai ka trajtuar periudhën e viteve 1991-2007, në vëllimin e tretë atë të viteve 2008-2013, dhe në vëllimin e katërt periudhën e viteve 2014-2022.

Me këtë vëllim, autorit Et'hem Ibrahimini i bëhen gjithsej rreth 2000 faqe botim, në të cilat ai ka derdhur pasion, vullnet, këmbëngulje dhe punë të palodhur, gjithçka që lidhet me sportin e boksit. Autori në botimet e tij është

Prezantohen tre libra të rinj të historisë së boksit shqiptar



ndaluar deri në ngjarjet më të hollësishme të sportit të boksit në Shqipëri.

Në këto botime përshkruhen në mënyrë kronologjike eventet e rëndësishme kombëtare, siç janë kampionatet kombëtare, kupat e Shqipërisë, kampionatet sipas moshave, aktivitetet ndërkombëtare zyrtare, turnetë ndërkombëtare etj. Ndër to, me një saktësi të admirueshme, jepen ekipet pjesëmarrës të çdo aktiviteti, boksierët, ndeshjet e zhvilluara, rezultatet etj., duke përbërë kështu një arkivë voluminoze të sportit shqiptar.

Vëllimi i 4 i autorit, i cili sapo ka parë dritën e botimit, flet për sportin e boksit në ditët e sotme, ku ka një vëmendje tjetër në vend si dhe veprimtari të shumta kombëtare e ndërkombëtare. Z. Et'hem Ibrahimini po punon për një monografi për 80 sportistët më të mirë shqiptarë, me titull, "Emërmëdhentë e Boksit shqiptar", ku do përfshihen edhe emrat e boksierëve të mëdhenj kosovarë. Vëmendje e rëndësishme iu

kushtua në aktivitetet gjithashtu promovimit të 2 botimeve të tjera të autorit Jani Nano, që vijjnë në vazhden e botimeve të mëparshme dhe e pasurojnë bibliotekën e boksit shqiptar. Autori është pedagog në Universitetin e Sporteve në Tiranë dhe punon me pasion për të hedhur në letër një përvojë që do të shërbejë sot dhe për të ardhmen, për brezat e sportistëve si një udhërrëfyes.

Aktivitetin e përshëndetën një numër folësish, pedagogë, ish-sportistë nga federata e Sporteve dhe ish-ushtarakë, të cilët ngritën lart punën e palodhur të 2 autorëve të këtyre librave. Ata vlerësuan se botimi i këtyre librave është një punë e madhe voluminoze e dokumentuar hap pas hapi të historisë së boksit shqiptar, të boksierëve të shquar dhe boksierëve amatorë si dhe të trajnerëve të pasionuar.

Botimi i këtyre librave vjen në momentin e duhur, kur boksi po fillon të përfaqësohet denjësisht, duke marrë medalje në aktivitete botërore, europi-



ane e ballkanike. Botimi i këtyre librave është një përvojë që duhet shpërndarë në brezat e rinj. Në përfundim të aktiv-

itetit, të dy autorët modestish përshëndetën dhe falënderuan pjesëmarrësit me nga një fjalë të shkurtër.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Një popull që ka dëshmorë, nuk njih robëri”

Përsëritje Ushtar i Panjohur!

Falë jush, unë kam një qiell të qetë mbi kokën time. Nuk e di çfarë është lufta, uria dhe të ftohtit. Keni bërë një sukses të madh, nuk harrohet!

Dhe fëmijët dhe nipërit e mi do të kujtojnë historinë më të lavdishme të tokës shqiptare. Ju dhatë jetën tuaj pa hezitim, dhatë gjithçka për Atdheun tonë.

Kujtesa të hap sytë, të bën të vlerësosh atë që ke tani, të mëson të arrish më shumë, më mirë dhe me përgjegjësi, se gjithçka ke sot, është paguar me jetë njerëzish dje...

Kujtesa ruan emrat në pllaka graniti, por gjëja kryesore është të ruash kujtesën në zemra. Studioj me interes historinë e viteve të luftës, lexoj për bëmat njerëzish e zakonshëm.

Sa herë që dikush flet për kujtesën, për luftën, më kujtohen fjalët e një kënge: “Nëse harrojmë luftën, lufta do të vijë përsëri”, dhe kjo është shumë e vërtetë. *Kur të harrojmë të gjitha tmerret e luftës, cilat vlera do të na sundojnë?*

Ka mjaft shembuj të betejave të ashpra në histori, por më ambiciozët janë ngjarjet e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

A nuk mjaftojnë këto sakrificat për të jetuar në paqe?

Pse ka ende urrejtje mes njerëzve? Pse të dëmtoni të tjerët? Nuk do t’ju bëjë të ndiheni më mirë dhe nuk do të bëjë askënd të ndihet më mirë.

Lufta është shumë e frikshme, brezi i ri nuk e njih dhe nuk do luftë, por as ju që keni jetuar më parë nuk e keni dashur. Keni ëndërruar, keni bërë plane, keni punuar, jeni argëtuar. Sa e vështirë duhet të ketë qenë të heqësh dorë nga gjithçka që ishte e çmuar. Kur shkuat në luftë, e dinit se mund të vdisnit, por pranuat të vdisni për hir të jetës sonë të ardhshme. Është e vështirë të kuptosh, por e di që duhet shumë guxim për ta parë vdekjen në sy.

Do të jetoni përgjithmonë mes nesh, sepse ju me veprën tuaj na bëtë të kuptojmë se çfarë vlere ka guximi, trimëria dhe sesa e rëndësishme është lavdia për flamur dhe atdhe...

Ju meritoni më të rëndësishmen vlerë njerëzore, Kujtesën.

Ju mbrojtët Atdheun nga armiqtë, për të na dhënë lirinë që ende sot popuj në mbarë botën nuk po e gëzojnë.

Tani ka konflikte në Irak, në Siri, Ukraina prej më shumë se një viti ndodhet nën agresionin Rus. Dhe kjo është e frikshme! Duke sakrifikuar jetën tuaj, ju na dhatë lirinë, të cilën nuk ta fal askush.

Çdo njeri duhet të shkojë t’i shërbejë vendit të tij.

I dashur Ushtar, jam krenar për ty! Sa do të doja që secili prej nesh të mund të bënte krenar vendin e tij për kontributin e tij. Muzë inspirimi janë



28 mijë bijtë dhe bijat e këtij vendi, që dhanë jetën e tyre për tonën. A ka sakrilegj më të madh se ky?!

Përsëritje Ushtar i Panjohur!

Sot lexojmë në tekstet e historisë, dëgjojmë shpesh në televizion se, më 7prill 1939, jeta paqësore e popullit tonë u prish nga një sulm.

Fashistët italianë po mësynin mbi trojet shqiptare. Vendi ynë hyri në një betejë vdekjeprurëse me një armik tinëzar.

Me qindra djem dhe vajza humbën jetën në këtë betejë.

Çdo i nëntë banor i vendit tonë nuk u kthye nga kjo luftë. Dhe mes tyre ju, Ushtari i Panjohur. Nuk hoqët dorë. Përballuat. Mbijetuat.

Nuk ka familje pa humbje në atë luftë. Ne e dimë se fashistët dhe më pas nazistët shkatërruan dhe dogjën qindra qytete, mijëra fshatra, kryen mizori të padëgjua, duke mos kursyer as të moshuar e as fëmijë, dhe asnjë vepër e vetme, asnjë film i vetëm nuk është në gjendje të përcjellë gjithçka që keni përjetuar në ato ditët e largëta lufte, për të ardhmen e diellitë.

Të shoh në fushën e betejës.

Ndoshta ju nuk ishit as 20 vjeç dhe nuk e dinit ende se kjo do të ndodhte dhe mund të vdisnit pa marrë një përgjigje nga vajza juaj e dashur, së cilës i keni shkruar një letër, ose ndoshta ishit tashmë një person mjaft i rritur dhe i arritët me tuajën qëllimet e jetës drejt së cilës do i ecnit me guxim, pa parë prapa.

Dhe armiku egër sulmoi. Dhe ti e ndalove! Ju bëtë gjithçka që armiku të mos pushtonte Atdheun tonë! Ju luftuat si titanë dhe me flamurin mbi gjoks,

ju fluturuar siç bijtë e shqipes dinë të turren vrullshëm mbi pushtuesit dhe plumbi i pabesë ju preu në mes ëndrrën, dashurinë, shpresën.

Ju luftuat për të vazhduar luftën. Gjithçka që mund të bëjmë është t’ju falënderojmë për guximin tuaj dhe të kujtojmë veprat tuaja. Brezi i ri di pak për heronjtë se të mëparshmit dhe çdo qytetar i Atdheut tonë duhet t’u thotë pasardhësve se ka pasur heronj si ju, që brezi i ri të nderojë dhe të respektojë fitoren tuaj!

Ne jetojmë nën një qiell të qetë.

Kemi njerëz të afërt. Gjithçka falë jush, ushtar i panjohur!

Nuk e di emrin tënd, por dua të të them “Faleminderit!” për arritjen tuaj të guximshme, për faktin që jetojmë në këtë botë. Ne kemi lindur dhe jemi rritur në një tokë paqësore.

Ne e dimë mirë se sa të zhurmshme janë stuhitë e pranverës, por bubullimat e armëve nuk i kemi dëgjuar kurrë. Ne shohim se si po ndërtohen shtëpi të reja, por nuk dyshojmë se sa lehtë shkatërrohen nën një breshëri bombash dhe predhash.

Jam e sigurt se askush nuk do të harrohet dhe bëma juaj do të mbetet përgjithmonë në zemrat dhe në kujtesën tonë. E di që dashuria vetëmohuese për tokën tuaj amtare dhe ndjenja e përgjegjësisë për të gjithë brezat e ardhshëm ju ndihmuan të fitoni këtë luftë më të tmerrshme.

Flaka e Përrjetshme

Në monumente janë përjetësuar emrat e të rënëve në atë luftë.

Një prej tyre është i Ushtarit të Panjohur, i cili qëndron në qendër të çdo qyteti si faltorja e të gjithë

njerëzve. Dhimbja jonë e përjetshme, Krenaria jonë e përjetshme. Kujtimi ynë. Ndërgjegjja jonë.

Kjo është simbolike: ju mbrojtët vatrat tona dhe mbetët rojtarët tanë të përhershëm, të përjetshëm.

I dashur Ushtari ynë i Panjohur, nuk do të marrësh kurrë një emër dhe mbiemër.

Për të gjithë ata, të dashurit e të cilëve ranë në frontet e Luftës së Madhe Patriotike, për të gjithë ata që nuk e morën vesh ku e dhanë jetën vëllezërit, baballarët, gjyshërit e tyre, Ushtari i Panjohur, do të mbetesh përgjithmonë ai personi i dashur që sakrifikoi jetën për të ardhmen e pasardhësve të tij.

Prushi i dashurisë për atdheun ju bëri që të binit në fushën e nderit dhe të mbeteni të pavdekshëm, të jetoni edhe pas vdekjes, të jeni të gjallë ndër të gjallët, të nderoheni, të kujtoheni, të frymëzoni. Përkulemi para jush!

I mban Toka në gji “pa ua prishur atë bukuri”!

Fjalët për atdheun i kthyet në vepër. Vepër madhështore! Atdheu ishte lulja më e bukur në zemrat e tuaja. Kështu ka ndodhur në Shqipëri ndër shekuj nga brezi në brez. E pamë në pikën më të lartë që ditën e parë të Luftës Antifashiste, kur ra heroji Mujo Ulqinaku me atdhetarë të tjerë. Në ato ditë, Hasan Mëhilli, që kryente shërbimin ushtarak, ra me fjalët e fundit në gojë: “Zjarr e hekur do të derdhim, shokë. Ta shohin çdo të thotë ta shkelin Shqipërinë”.

Shqipëria u pushtua, por nuk u nënshtrua.

Partizanët, ngado që shkonin, nga mali në mal, nga beteja në betejë, e

merrnin atdheun me vete, e kishin në zemër. Ideali atdhetar i shtynte që me pushkë në dorë të luftonin për Shqipërinë. Kishin ardhur ato ditë, për të cilat ëndërronte Asdreni: “Lart, përmbi shkëmbinj/atje tek shqiponjat rrinë/Tomor, atje mblidhi të rinjtë/ të përpiqen për lirinë”.

Dhe partizanët bënë atë që thotë kënga e tyre, “N’ ato maja, rripa-rripa, se ç’ gjëmojnë/Ndizet lufta për liri dhe derdhet gjak/Janë trimat partizanë që luftojnë”. Dhe në luftë binin dëshmorë bijtë e shqipes. Sa shembuj të lartë atdhetarie ka në radhët e partizanëve!

Kristaq Tutulani në ditarin e tij do të shkruante: “O Shqipëri, o nënë e dhimbshur! Hiqe zinë sot: ja, pleq e të rinj, bijtë e tu, gjaku më i kulluar, është gati të derdhet... Që tani e tutje s’ka më pushim, por luftë gjer në vdekje...”. Partizani luftonte “me kokë në torbë” dhe nuk pyeste për jetën e tij. Fjalët e Sadik Stalavecit, i cili thoshte: “Gjëja më e madhe është t’i japësh jetën atdheut, por njëkohësisht duhet të dish si t’ia falësh”. Dhe vetë ra si hero në kodrën e kuqe.

Ata ishin modeli i atdhedashurisë

Ende pa dalë partizanë me armë në dorë, këta luftëtarë betoheshin, duke shkruar për atdheun dhe prisnin rastin të shkonin drejt maleve, atje ku ishte “Foleja e partizanëve”! Fliste edhe pena e tyre. Fliste gatishmëria e tyre. Gjaku që vlonte për tokën mëmë, për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Dhe binin dëshmorë me dy armë: me pushkë dhe penë!

AMBASADORË DHE USHTARAKË TË LARTË TË NATO-S, NË BAZËN BËRTHAMORE 'CLYDE' TË MB-SË

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sipas 75-vjeçarit britanik, "Deri vitin e kaluar, 'Google' veprimi si një kujdestar i duhur për teknologjinë, duke u kujdesur që të mos lëshonte diçka që mund të shkaktoje dëm. Por tani që 'Microsoft' ka shtuar motorin e tij të kërkimit Bing me një chatbot, duke sfiduar biznesin kryesor të 'Google' - Google po garon për të vendosur të njëjtin lloj teknologjie. Gjigantët e teknologjisë janë të bllokuar në një konkurrencë që mund

të jetë e pamundur të ndalet." Ai deklaroi se shqetësimi i tij i menjëhershëm është se interneti do të vërshohet me foto, video dhe tekste false dhe njeriu mesatar nuk do të mund të dijë më se çfarë është e vërtetë.

Ai gjithashtu shqetësohet se AI do të shqetësojë tregun e punës pasi tashmë, chatbotet si ChatGPT përdoren tani për të plotësuar punëtorët njerëzorë, "por ata mund të zëvendësojnë asistentët personalë, përkthyesit dhe të tjerët që merren me detyra të tilla. Kjo mund të marrë më shumë se kaq", - tha ai.

Geoffrey Hinton është një pionier i inteligjencës artificiale. Në vitin 2012, Dr. Hinton dhe dy nga studentët e tij të diplomuar në Universitetin e Torontos krijuan teknologjinë që u bë themeli intelektual për AI-në sistemet që kompanitë më të mëdha të industrisë së teknologjisë besojnë se janë një çelës për të ardhmen e tyre, raportoi NYT.

"Heroina e Popullit", Zonja Çurre, trimëresha e Tragjasit

Në Tragjas të Vlorës, në vitin 1920, lindi luftëtarja Zonja Çurre. Tragjasi ishte i dëgjuar për tradita të hershme luftarake, por mbi të gjitha si një vend i arsimuar dhe me kulturë të gjerë. Nga ky fshat kishin mësuar dhe përfunduar studimet në vendet perëndimore në fillimin e shek. XX mbi 60 të rinj. Po nga ky fshat kishte mjaft të emigruar kryesisht në SHBA, të cilët në vijimësi sollën një kulturë jetese dhe përparimi. Këtu edhe gratë e vajzat ishin të arsimuara, luftëtare dhe qëndronin përkrah burrave dhe vëllezërve të tyre, si në qëndresën e qeverisë së Vlorës të vitit 1912, në luftërat e viteve 1913-1914, ashtu dhe në Luftën e Vlorës të vitit 1920. Në këtë mjedis luftarak u rrit dhe u formua dhe luftëtarja e ardhshme e lirisë. Ajo e kaloi jetën e saj mes vështirësive dhe vuajtjeve, ku babai e la të vogël dhe duhej të punonin familjarisht me nënën, vëllezërit dhe motrën për të mbajtur frymën gjallë. Vështirësitë e rritën dhe e kalitën përpara kohe.

Këshilli i grave antifashiste të fshatit në vitet e LANÇ-it bëri një punë të madhe për furnizimin e çetave me materiale për partizanët, por edhe për të shtuar radhët e tyre me vajza e gra luftëtare. Në përgjigje të thirrjeve të bëra për pjesëmarrje në luftë nga Fronti Nacionalçlirimtar dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, mbi 40 vajza e gra dolën luftëtare dhe u rreshtuan në repartet dhe njësitë partizane nga fshati Tragjas. 10 prej tyre ranë në ballë të luftës kundër pushtuesve, populli i përjetësoi me këngë heroizmin e tyre. Ndërsa 6 gra e vajza u plagosën në luftë. Në Kongresin e Parë Antifashist të Grave të Shqipërisë të mbajtur në Berat, morën pjesë nga Tragjasi Hanko Muço, Afërdita Thanasi e Inajete Ramadani.

Lufta dhe aksionet që ndiqnin njëri-tjetrin, krahas burrave, përfshiu edhe mjaft gra. Kështu, në Luftën e Drashovicës, në shtator 1943 gratë e Tragjasit ishin të mobilizuara plotësisht, duke qëndruar çdo ditë pranë partizanëve në front dhe i ndihmuan me çdo mjet si furnizim me bukë, ushqime e municione dhe transportim të të plagosurve për në spitalet partizane. Gjatë operacionit të Dimrit, midis viteve 1943-1944, gratë e Tragjasit shpinin thasë me bukë në mal të fshatit e në Shpellën e Kavasallit, ku ishin grumbulluar rreth 170 partizanë, midis të cilëve kishte edhe të plagosur. Shumë gra nga Tragjasi çuan në spitalin e Ramicës ushqime e materiale të tjera për partizanët e plagosur.

Zonja ishte në ballë të aksioneve. Në mbarë Shqipërinë, në qytete e fshatra ishin krijuar njësite guerile, u shfaqën çetat e para partizane. Në rrethin e Vlorës u krijuan çeta "Plakë", "Rinia", "Halim Xhelo", "Hodo Zeqiri", "Zigur Lelo", "Ismail Qemali" e të tjera. Zonja Çurre i simpatizonte dhe i donte luftëtarët e lirisë. Shpesh u vinte në ndihmë, duke ndarë kafshatën e bukës, duke i prituri e i përcjellë, duke thurur triko dhe çorape për ta. Zonja u zgjodh përgjegjëse e rinisë në Tragjas. Në fillim të vitit 1943, la mënjandë punët e shtëpisë dhe iu kushtua gjithë kohën çështjes së luftës për çlirim. Zonja Çurre mori pjesë në mjaft aksione të rëndësishme në zonën e Vlorës. Ajo u dallua për iniciativë e trimëri, sidomos në Luftën e Drashovicës në shtatorin e vitit 1943, ku me shembullin e saj u gjend në ballë të sulmit për marrjen e garnizonit të Drashovicës.

Kur Zonja do të nisej për në çetën partizane, nëna e pyeti: "Si mund të shkosh kështu në luftë? Pastaj, je vetëm, pa njeri dhe e shqetësuar", iu lut dhe të priste... Por Zonja, ashtu siç ishte, duke nxituar dhe e vendosur të dilte luftëtare iu përgjigj:

- Nuk jam vetëm, jo, nënë. Kam edhe dy shokë. Dy shokë të fortë.

- Po ku janë, sillu t'i shoh, t'i njoh edhe unë ...

- Ja ku janë, nënë. - Zonja kishte nxjerrë nga xhaketa dy bomba dhe i mbante në duar. - E sheh që s'jam vetëm?

Detyrën e drejtueses në luftë, Zonja e pati atë të komandantes së skuadrës.

Operacioni armik i Dimrit i vitit 1944 ishte në kulmin e tij. Në Tragjas u përhap lajmi se një skuadër partizane, duke çarë me guxim dëborën e stuhinë e dimrit të egër, kishin kaluan Qafën e Shëngjergjit në lindje të Dukatit, në drejtim të malit të Lungarës dhe kishin rënë në përpjekje me forcat gjermano-balliste. Skuadërkomandantja e kompanisë së katërt të batalionit të katërt, Zonjë Çurre bashkë me 14 partizanë, gjatë ofensivës së dimrit luftoi me heroizëm, si me natyrën, ashtu edhe me repartet e zbulimit gjerman në Qafën e Shëngjergjit. Por asnjë nga këto vështirësi nuk e pengoi skuadrën që komandonte ajo, të kryente detyrën që ishte ngarkuar për vendosjen e lidhjeve të batalionit me një pjesë të forcave të tij, të cilat në këtë kohë ishin futur në prapavijat e armikut dhe vepronin në malet e Tragjasit, në Radhimë e Mazhar. Në këtë dimër të ashpër ngrinë nga të ftohtit e madh partizanët, bij të Tragjasit: Kujtim Hoxha, Lilo Asllani e Azbi Mete.

Tre partizanë të rinj, shokë të saj, të dobësuar nga vuajtjet, me këmbët e ënjtura nga dëborë ishin gati të mbeteshin në dëborë. Ajo i mori në krahë, megjithëse edhe vetë ishte e lodhur dhe këmbët i kullonin gjak. U zvarrit me shokët e saj në krahë, bëri gjithçka ishte e mundur për t'i shpëtuar ata. Koha ishte e keqe, dëborë e madhe, opingat i humbën, mishrat e këmbëve i ranë. Zonja marshoi! Tre



shokët i mbetën. Gjysmë e vdekur arriti në Tragjas. "Shpëtoni, shpëtoni shokët!", - ishin fjalët e saj të fundit dhe ra pa ndjenja.

Por Zonja, në mes të kësaj lufte, kur Atdheu kishte shumë nevojë për bij të tillë, nuk mund të qëndronte shumë kohë e shtrirë në krevat. Ndonëse këmbët i kishte të ënjtura e të çara, fytyrën krejt të hequr, të dobësuar, me t'u përmirësuar disi, u nis për në batalion tek shokët e saj. Komanda e batalionit e porositi Zonjën të qëndronte disa ditë në spital, gjersa t'i shëroheshin mirë këmbët dhe të merrte veten por ajo nuk pranoi.

Fjalët e luftëtares e komandantes kur i kërkoi të shtrohej në spitalin partizan ishin: "Unë kam ardhur të qëndroj me shokët e mi të luftës, të luftoj bashkë me ta, të marr pjesë në çdo aksion dhe të hakmerrem mbi armikun dhe tradhtarët. Unë nuk i harroj porositet e Hazbiut, Lilos dhe Kujtimit që më thanë, kur u ndava prej tyre në malin me dëborë të Dukatit. Nuk harroj vuajtjet, këmbët e tyre të zbatuara e të ënjtura, duart e tyre të ënjtura e të gjakosura, fytyrën e tyre të re dhe të njomë, të jeshilosur nga vuajtjet e rrugës. Nuk harroj plagët e shokëve, dhe gjakun që u rridhte në shpatullat e mia, në Qafën e Shëngjergjit. Jo shoku komisar, dua të luftoj me çdo kusht!"

Zonja Çurre mori pjesë në shumë aksione nga më të rëndësishmet që bëri Brigada e V Sulmuese. Kudo ajo tregoi virtytet të larta të partizanes, guxim, vendosmëri të papërkulur. Pas

operacionit armik të Dimrit, ajo u gjend përsëri në rreshtat e Brigadës së V Sulmuese. Duke çmuar vendosmërinë dhe guximin e rrallë të saj, shtabi i brigadës e ngarkoi me detyrën e komandantes së skuadrës. Kur Divizioni I Sulmues kaloi lumin Shkumbin për çlirim të Shqipërisë së Mesme e të Veriut, Zonja u bë shembull vendosmërie e vetëmohimi për luftëtarët. Kudo që u paraqit rasti, në përpjekje të vogla e të mëdha, ajo ishte në krye të detyrës. Si luftëtare e Brigadës V Sulmuese, ajo diti të përballojë me heroizëm të shkëlqyer të gjitha vështirësitë e jetës partizane: lodhjen dhe pagjumësinë, etjen, urinë, të ftohtin e madh, vapën e padurueshme, ashpërsinë e betejave.

U ngarkua me detyrën e zëvendëskomandantes së kompanisë. Shtabi i brigadës kishte besim të madh tek Zonja. Ajo hidhej e para në sulm dhe qëndronte e fundit në tërheqje, gjithmonë duke shtrenguar fort me të dy duart mitralozin e saj. Nuk ishte vetëm një trimëreshë, por edhe një agjitore e flaktë për çështjen e popullit.

Në librin "Fragmente nga epopeja e lavdishme", komandanti i Br. V S, Shefqet Peçi shkruan: "Edhe gjatë ditës së 22 korrikut 1944, forcat e batalionit të kësaj brigade vazhduan luftimet kundër forcave të mëdha tradhtarë në Gurabardhë, duke i shkakuar kundërshtarit humbje të rënda. Në këtë luftë ra heroikisht Zonja Çurre, e cila ishte nënkomandante kompanie. Ajo ishte me të vërtetë një trimëreshë, gjithmonë në

ballë të kompanisë dhe nuk i trembej syri kurrë.

Zonja Çurre ndodhet kudo në ballë të aksioneve dhe kudo lufton me trimëri, duke u bërë kështu një luftëtare e shquar për çështjen e çlirimit të popullit tonë. Ajo mendonte vetëm për luftë, ishte serioze, por e dashur me shokët. E gjithë kompania e kishte në zemër, e respektonte dhe zbatonte me përpikëri urdhrat e saj. Megjithëse nënkomandante kompanie, Zonja nuk e lëshonte kurrë mitralozin nga dora, ishte vetëm trimëreshë, agjitore e flaktë për çështjen e popullit. Ai do t'i kushtonte një poezi ku theksonte:

Nga ti morën shembull të rinj e të reja/ trimëresha vend, flakë si rufeja./ Në ballë të luftës ti luftoje shpesh./ Nuk të trembej syri nga plumbat rrebesh.

Vlerësimi për luftëtarin

Për guxim të rrallë dhe heroizëm të treguar gjatë LANÇ-it, Zonja Çurre është shpallur Dëshmore e Atdheut dhe vlerësuar me titullin "Heroinë e Popullit". Shumë shkolla dhe rrugë të atdheut mbajnë emrin e saj. Për të janë shkruar dhe shkruhet në shtyp, janë bërë libra, janë bërë këngë dhe poema, janë bërë portrete, tablo dhe buste. Zonja Çurre është bërë simboli i luftëtares, i një vajze të guximshme, e cila në kushte mjaft të vështira të terrenit dhe të motit, por edhe të luftës diti të mbijetonte dhe të bëhet burim frymëzimi dhe ideali për mjaft gra dhe vajza të Shqipërisë.



1 maji, historia e protestave në kujtim të martirëve që përcaktuan të drejtat e punëtorëve në mbarë botën

Origjina e parë e Ditës së Punëtorëve të Illinois i ka rrënjët në një periudhë demonstrimesh të rëndësishme dhe të shpeshta për të drejtat e punëtorëve të fabrikës gjatë Revolucionit Industrial në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të udhëhequr nga Shoqata e Urdhrit të Kalorësve të Punës. Në 1866, ligji i parë për tetë orë punë në ditë u miratua në Çikago, Illinois, një ligj që hyri në fuqi vetëm vitin e ardhshëm, më 1 maj 1867, ditë në të cilën u organizua një demonstratë e madhe, me të paktën dhjetë mijë pjesëmarrës. Lajmi arriti edhe në Evropë, ku në ditët e para të shtatorit 1864 lindi në Londër “Internacionalja e Parë”, ose Shoqata Ndërkombëtare e Punëtorëve, fare pranë lëvizjeve të para socialiste dhe marksiste të kohës.

Tetë orët e punës

Pushtimi i tetë orëve të punës, i cili filloi më 1 maj 1867, vetëm në shtetin e Illinois, pati një zgjerim të ngadalshëm dhe gradual të mëvonshëm në të gjithë Shtetet e Bashkuara. Vendosija e tetë orëve punë, që filloi më 1 maj 1867 në shtetin e Illinois, pati një zgjerim të ngadalshëm dhe gradual të mëvonshëm në të gjithë Shtetet e Bashkuara. Përsëri në vitin 1882, në qytetin e Nju Jorkut, u organizua një protestë e rëndësishme më 5 shtator, ndërsa dy vjet më vonë, në 1884, në një demonstratë të ngjashme amerikane, vetë Kalorësit e Punës miratuan një rezolutë që manifestimi i protestës të kishte një vit përsëritje, por pa propozuar ende një datë zyrtare në Illinois. Po më 1 maj, Çikago mori pjesë gjithashtu në grevën e përgjithshme, më së shumti në Fabrika e Harvesterit McCormick. Policia, e thirrur për të shtypur tubimin, qëllon mbi demonstruesit, duke vrarë dy dhe duke plagosur disa të tjerë. Për të protestuar kundër brutalitetit të policisë, anarkistët vendas organizuan një demonstratë që do të mbahej në sheshin Haymarket, sheshi që zakonisht strehonte tregun e makinerive bujqësore. Këto ngjarje arritën kulmin më 4 maj, kur një bombë u hodh nga një rrugë anësore, e cila shkaktoi vdekjen e gjashtë policëve dhe plagosjen e rreth pesëdhjetë të tjerëve. Në atë moment policia qëllon mbi demonstruesit. Askush nuk e ka ditur ndonjëherë numrin e viktimave apo kush e hodhi bombën. Ky ishte bombardimi i parë me dinamit në historinë e SHBA-ve.



Më 20 gusht 1887, u dha vendimi i gjykatës: August Spies, Michael Schwab, Samuel Fielden, Albert R. Parsons, Adolph Fischer, George Engel dhe Louis Lingg u dënuan me vdekje (pas presionit ndërkombëtar, dënimi me vdekje i Fielden dhe Schwab u zëvendësua me burgim të përjetshëm; kancelari Otto von Bismarck ndaloi të gjitha demonstratat në favor të të akuzuarve të Haymarket); Oscar W. Neebe ra në burg për 15 vjet. Tetë burra u dënuan si anarkistë dhe shtatë prej tyre u dënuan me vdekje. Më 11 nëntor 1887, të dënuarit u varën të gjithë në Çikago. Fjalët e fundit që u thanë ishin:

- *Spionë: “Përshëndetje, do të vijë dita kur heshtja jonë do të jetë më e fortë se zërat që sot mbyten nga vdekja!”*
- *Fischer: “Hoch die Anarchie!” (Rroftë anarkia!)*

- *Engel: “Urra për anarkinë!”*
- *Parsons, agonia e të cilit ishte e tmerrshme, mezi fliste, sepse xhelati e shtrëngoi menjëherë lakun dhe e lëshoi kurthin. Fjalët e tij të fundit ishin këto: “Bëjeni zërin e popullit të dëgjohe!”*

Dita e 1 majit përhapet në mbarë botën

Në vitin 1887, presidenti i atëhershëm i SHBA-ve, Grover Cleveland, besonte se 1 maji mund të ishte një mundësi për të përkujtuar episodet e përgjakshme në Çikago. Më pas, nga frika se përkujtimi mund të përforconte së tepërmi socializmin e sapolindur, ai e zhvendosi objektin e festës në Organizatën e lashtë të Kalorësve të Punës. Megjithatë, vetëm pak ditë pas sakrificës së të ashtuquajturve Martirë të Çikagos, vetë punëtorët e qytetit amerikan mbajtën një



demonstratë masive zie, dëshmi se idetë socialiste nuk ishin aspak të vdekura.

Data e 1 majit u miratua për shembull në Kanada vetëm në 1894, megjithëse koncepti i Ditës së Punës në këtë rast i referohet marshimeve të mëparshme të punës të mbajtura në Toronto dhe Otava në 1872.

Në Kongresin Ndërkombëtar në Paris të 1889, ku filloi Internacionalja e Dytë, 1 Maji u shpall zyrtarisht si Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve dhe u miratua nga shumë vende të botës. Në anën tjetër të hemisferës tokësore, si

në Australi, përkujtimi kujton “Festën e Tetë Orëve” (punë). Megjithatë, në zonën e Queensland-it, nëse fillimisht përdorej për ta festuar atë më 1 maj, në kohët më të fundit dhe gjithashtu në zona të tjera australiane është zakon që të bjerë të hënën e parë të majit, ose në mars, por edhe tetor. Përkujtimi u rifillua më pas edhe nga bota katolike: më 1 maj 1955, Papa Piu XII krijoi festën e Shën Jozefit Punëtor për të gjithë Kishën Katolike, në mënyrë që kjo datë të mund të ndahej plotësisht edhe nga punëtorët katolikë.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Organizimi i strukturave dhe formacioneve

Me krijimin e shtetit shqiptar të pavarur, vërtiteshin e dyndeshin probleme dhe vështirësi të mëdha. Ndër të parat ishin dhe organizimi i strukturave dhe formacioneve të Forcave të Armatosura Shqiptare. Këto duhej të bënin mbrojtjen e vendit nga pushtuesit fqinj, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të rendit. Në këtë kohë vendi ishte i izoluar tërësisht. Shtetit të ri i nevojiteshin ushqime, armatime dhe municione, pajisjet dhe veshjet e domosdoshme për të mbajtur forcat ushtarake. Sapo ishte krijuar infrastruktura e nevojshme, që ishte e paktë dhe e pafuqishme për realizimin e detyrave dhe qëllimit për të cilat ishin ngritur. Veprimet luftarake mbrojtëse vijonin dhe vendin e kërcënonin rreziqe të reja.


Mehmet Pashë Dërralla, i ndihmuar prej 15 oficerësh holandezë, nën komandën e kolonel De Veer, formoi një xhandarmëri prej 4 000-5 000 vetë si mbrojtje e parë ushtarake për qeverinë e re. Xhandarmëria u nda në detashmente, kompani dhe kalorësi me 120 ushtarë. Këto kishin veshje italiane, si dhe ishin të pajisur me pushkë, topa dhe mitraloza. Komandën në këtë xhandarmëri e mori Gilhard. Fuqitë e Ismail Qemalit u ndihmuan dhe nga Aqif Përmeti, i cili në SHBA, kishte mbledhur vullnetarë shqiptarë, si dhe kishte organizuar bandën "Vatra". Qeveria kërkoi nga komandanti i Beratit, Kara Said Pasha, për të siguruar rezerva me armë, municione dhe materiale luftarake nga ushtria e tij, para se të largohej për në Turqi.

Në këto rrethana Majori Ali Shefqet Shkupi erdhi në Shqipëri nga fundi i prillit 1913. Në moshën 30-vjeçare, ai ishte një personalitet i njohur, ushtarak i talentuar dhe atdhetar i njohur dhe i afirmuar. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe Ministria e Luftës i ofruan atij postin e rëndësishëm dhe të vështirë të Kryetarit të Shtabit Madhor (Shtabit Madhner).

Kështu, më 4 maj 1913, doli vendimi për krijimin e Shtabit Madhor nga Qeveria e Vlorës. Për ndërtimin e Forcave të Armatosura Shqiptare, Ali Shefqeti me energjinë, dinamizmin dhe talentin e tij, si dhe të bashkëpunëtorëve, gërshetoi mjaft mirë përvojën, mençurinë dhe moshën e gjeneral Dërrallës, duke u përpunuar me realitetin shqiptar të asaj kohe.

Ngritja dhe vënia në lëvizje e këtij organizimi pati një rëndësi të veçantë për ushtrinë. Ky veprim shënoi një nivel të ri të organizimit të saj. Vetë shtabit përbënte një

Arsyet, domosdoshmëria e krijimit dhe karakteri gjithshqiptar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, në vitet e para të shtetit shqiptar



dukuri dhe praktikë bashkëkohore të përparuar dhe njëkohësisht dëshmonte kulturën e mirë politike e ushtarake të drejtuesve të shtetit. Nga pikëpamja organizative shtabi përbëhej nga: qarqet e shtabit madhner, shkresina e shtabit madhner, komisioni i rregulloreve dhe ushtrimeve, komanda e trajtimit të policisë e xhandarmërisë dhe komisioni i ndërtimit. Shtabi Madhor ishte konceptuar dhe ndërtuar, por edhe veprori, si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Kjo do të thoshte se ai edhe nga ana praktike ishte përgjegjës kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimeve luftarake të FA-ve.

Misioni i shtabit madhner ishte organizimi, përgatitja dhe drejtimi profesional i veprimeve luftarake të Forcave të Armatosura. Shtabi Madhor u strukturua dhe u organizua me disa zyra të nevojshme dhe vijoi ndërtimi i strukturave të FA-së, ku u përfshinë forcat aktive, rezerviste dhe vullnetare. Në kuadrin e organizimit të forcave aktive të ushtrisë Shqiptare, në linjën e raporteve me Ministrinë e luftës, të cilën e informonte rregullisht, kryetari i shtabit Madhor e njoftonte, më 31 maj 1913, për punën që bëhej për të organizuar kompaninë model në Vlorë, me ushtarë shqiptarë.

Ministria e Luftës dhe Shtabi Madhor filluan të punonin me përkushtim dhe profesionalizëm në përgatitjen e rregulloreve ushtarake. Në to përcaktohej mënyra e organizimit, rekrutimit ushtarak, drejtimi i forcave,

jeta dhe stërvitja e ushtrisë së re shqiptare. Kështu Shtabi Madhor u angazhua për të diskutuar dhe miratuar në Qeverinë e Vlorës "Rregulloren e organizimit (formimit) të Milicisë Shqiptare", të dokumentuar më 3 qershor 1913.

Krijimi i milicisë ishte i domosdoshëm deri sa të formohej dhe organizohen në një shkallë të nevojshme. Ushtria e rregullt shqiptare. Në këtë rregullore, me artikuj (nene) të veçantë qartësoheshin problem të organizimit, të detyrimit ushtarak, të hierarkisë, detyrat luftarake, çështje të administrimit, të rregullit ushtarak etj.

Ky dokument tipik bashkëkohor, flet edhe sot pas 110 vjetësh për nivelin kulturor dhe profesional të këtyre ushtarakëve, por që dëshmon edhe për përmasat e ushtrisë shqiptare dhe të seriozitetit të saj.

Ushtria shqiptare me kërkesa të një ushtrie të rregullt

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 29 korrik 1913, vendosi pavarësinë e plotë të Shtetit Shqiptar. Ajo caktoi një komision ndërkombëtar për kontrollin e xhandarmërisë. Kjo forcë do të organizohej nga oficerë suedezë për të siguruar qetësinë dhe rregullin e brendshëm. Deri në këtë vit nuk mund të flasim dhe përmendim për ndonjë ushtri shqiptare të rregullt.

Në gjysmën e dytë të vitit 1913, Shtabi Madhor sipas planit të miratuar nga Ministria e Luftës, po organizonte një ushtri shqiptare me kërkesat e

një ushtrie të rregullt. Kjo u duk në organizim, në pajisje, në armatim, në veshje dhe në stërvitje. Kështu u organizua një kompani model, që më pas do të ndiqej nga disa të tjera. Kështu u porositën në Austri armatime (topa, mitraloza), municione, uniforma të nevojshme për një ushtri të rregullt. U bashkëpunua me oficerë holandezë, si koloneli De Veer, që u morën me organizimin dhe stërvitjen e Xhandarmërisë shqiptare.

Për herë të parë në shtetin shqiptar u zbatua ligji ushtarak i rekrutimit. Kështu u porositën prefekturat e vendit për procedurat e rekrutimit të djelmohave shqiptarë për shërbim të rregullt ushtarak. Në kreun e kësaj

rregulloreje të "Detyrimit Ushtarak", theksohej se shërbimin ushtarak do e kryente "çdo mashkull nga moshja 20-40 vjeç, që është në gjendje të mirë shëndetësore". Merita e këtij shtabi ishte plotësimi i nevojave të ushtrisë me rregullore, duke i shqipëruar ato nga literatura bashkëkohore.

Mbërritja e princ Vidit, në mars 1914, në Shqipëri ndodhën luftime të pjesshme kundra armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Në statusin e Principatës Shqiptare bëhej fjalë për një lloj ushtrie, duke u organizuar në Milici, që të mos ishte në kazerma, por të mblidhej për ushtrime dhe stërvitje. Në kohën e Vidit nuk pati ndonjë përparim për sa i përket ushtrisë. Xhandarmëria e organizuar nga koloneli Tomson, sidomos në Durrës ishte prej kontingjentesh vullnetarësh, si dhe një bateri të vogël artilerie.

Shënohet një përparim në këtë periudhë, kur Ali Kosturi, në krye të 250 ushtarëve dhe 50 kalorësve të xhandarmërisë, u ngarkua t'u bëjë ballë fuqive greke që kërcënonin Korçën. Aty kishte dhe xhandarë nga Vlora, por që ishin shumë të dobët për plotësimin e detyrës së ngarkuar. Kështu në bashkëpunim me prefektin e Korçës Pandeli Evangjelin, u formua një ushtri e vogël për mbrojtjen e kufirit. Kështu u thirrën në shërbim 20-40-vjeçarë dhe formuan nga në batalion në qendrat: Kolonjë, Korçë, Devoll dhe Starovë. Komanda e këtij regjimenti u vendos në Korçë, ndërsa batalionet u ndanë në kompani dhe u shpërndanë në kufi. Oficerët kishin veshur uniforma dhe ushtarët me bluza ushtarake dhe kasketa në formë angleze dhe të armatosur



me pushkë. Organizimi i rregullt në ushqime dhe transport i dha formë kësaj ushtrie dhe me ndihmën e oficerëve holandezë. Ky organizimi mund të quhet si formacion i parë ushtarak i rregullt i Shtetit të ri.

Masa për ngritjen e fuqive ushtarake të popullit shqiptar

Koha nga largimi i Princit deri në ardhjen e Fuqive të Antantës. Në Shqipëri sundoi anarkia dhe u mbush me luftëra në çdo cep të saj. Gjatë Luftës së Parë Botërore në Shqipëri nuk mund të flitej për institucione të mirëfillta legjitime e kombëtare, vendin e kishte mbërthyer anarkia. Ushtritë e Fuqive të Mëdha, Austro-Hungaria dhe Italia e Franca hynë në Shqipëri nga viti 1915. Ato morën masa për ngritjen e fuqive ushtarake të popullit shqiptar, ku secila nga këto fuqi përpiquej të ndihmonte në rikrijimi e Shqipërisë independente.

Italianët në zonën e tyre të pushtimit formuan dy batalione me nga katër kompani secili. Komandantët e këtyre njësive deri në fund të luftës ishin italianë. Nga fundi i luftës në rreshtat e këtij legjioni disa shqiptarë që kishin mbaruar në Itali kurse dhe Akademi Ushtarake. Qendra e batalioneve ishte në Gjirokastrë, Delvinë dhe më pas në Përmet. Ushtarët e batalioneve paguheshin çdo ditë, u jepej bukë, kafe e sheqer. Kishin të veshur uniforma italiane dhe si shenjë dalluese mbanin një qeleshe të bardhë me simbolin e shqiponjës. Armatimi i tyre përbëhej nga pushkë dhe mitraloza italianë. Në këtë periudhë u formuan kompani me trupa vullnetarë shqiptarë, që udhëhiqeshin nga shqiptarë dhe ishin të pavarur nga komanda italiane.

Fuqia e këtyre forcave u përdor për të forcuar kufirin dhe mbrojtur vendin në pjesën jugore të Shqipërisë nga Korça në Vlorë. E veçantë është se batalionet e rregullta vepruan sipas rregullit dhe të gjitha ushtrimeve të stërvitjeve të rregulloreve përkatëse, ndërsa batalionet e parregullta luftonin sipas traditave të tyre. Në këtë periudhë kujdesi i austriakëve për stërvitjen ushtarake ishte tepër i veçantë, pasi në këtë vit ata kishin pushtuar pjesën më të madhe të Shqipërisë. Në këtë kohë, nga bisedimet e austriakëve me Malin e Zi, u liruan mjaft personalitete shqiptare që ishin internuar aty.

Sukses të dukshëm pati Gilhardi, i cili me ndihmën e Ahmet Zogut, mblodhi një kontingjent dhe veproi në qarkun e Vlorës, ku krijoi nëntë batalione me nga 500 veta secili. Ndërsa në krahinën e Korçës formacionet vullnetare nën komandën e Sali Butkës, mbrojtën juglindjen e vendit. Trupat austro-hungareze marshuan drejt Vlorës dhe më pas u shtrinë në Berat e Pogradec, u organizua një rregull i ri në formacionet vullnetare. Kështu në çdo sektor u vendos dhe një kompani shqiptare, duke shërbyer bashkë me austriakët.

Në Shkodër dhe në Krujë e qendra të tjera, duke i lëshuar udhë një logjike më të mirë, u organizuan shumë batalione shqiptare, si rezerva dhe të rekrutuar. Të gjitha këto masa për të



mësuar popullsinë që në këtë periudhë nuk njihnin aspak rekrutimin dhe shërbimin ushtarak. Në fillim këto batalione përbëheshin prej vullnetarëve, por më pas hyri në fuqi rekrutimi. Kështu formacionet e reja filluan stërvitje ushtarake nga oficerë austriakë dhe nënoficerë boshnjakë, si dhe aspirantë shqiptarë që kishin bërë kurs në Shkodër. Më pas u krijuan dhe dy batalione me malësorë, ku secili prej tyre kishte flamurin e kuq me shqiponjën e zezë. Kështu në paradën e mbajtur para Komandantit të Truparmatës, gjeneralit Trollman, batalionet shqiptare morën me të drejtë lavdërime për qëndrimin e bukur të tyre.

Kështu filloi stërvitja ku u trajnuan 1 500 luftëtarë. Rreth 40 djem shqiptarë u dërguan në shkollat ushtarake të Austrisë dhe një pjesë e tyre u kthye në atdhe mbas luftës, ku hynë në ushtrinë shqiptare dhe shërbyen me devotshmëri. Të gjitha këto formacione u shpërndanë

me mbarimin e Luftës së Parë Botërore. Qëndroi vetëm një, batalioni i milicisë nën komandën e Mark Rakës dhe më pas të Ismail Tatzatit që ishin në Gjirokastrë e Delvinë. Ky batalion më pas u vendos në Korçë pas largimit të francezëve dhe një pjesë në Tiranë. Në këtë periudhë në Kosovë formohet një batalion milicie, nën drejtimin e Ali Rizait, i cili ende vazhdonte t'i qëndronte besnik ushtrisë, por dhe ky u shpërnda shpejt. Në këtë periudhë të luftës u stërvitën oficerë dhe ushtarë, si në drejtim të artit të luftimit, por edhe në drejtim të bashkëpunimit dhe të pajisjes me armatim e municione të kohës. Nga sasia e madhe e materialit të luftës që lanë ushtritë e huaja që po tërhiqeshin nga vendi, u pajis ushtria e më pastajshme.

Rimëkëmbja e ushtrisë dhe shtatmadhoria

Gjatë okupacionit Italian, deri në

gusht 1920, në Durrës u përqendruan mjaft oficerë, ku nën komandën e Kapitenit Ismail Haku u organizua një Xhandarmëri vendase. Italianët e përkrahën këtë organizim dhe prunë në Shqipëri nënkolonelin Ridolf dhe karabinierë. Kështu në Tiranë u çel një shkollë për oficerë dhe aspirantë të Xhandarmërisë. Duke kryer një kurs deri në katër muaj, në gusht 1919 u formua një batalion xhandarmërie. Kështu në qendrat e prefekturave u ngritën komanda batalionesh, në nënprefektura, komanda kompanish dhe në krahina komanda toge e posta të nevojshme. Me këtë organizim të ri u larguan karabinierët dhe shërbimi i xhandarmërisë në të gjithë tokën shqiptare u besohej formacioneve vendase.

Qeveria e Kongresit të Lushnjës, në janar 1920, krijoi Ministrinë e Luftës, me në krye gjeneral brigade Ali Riza Kolonjën. U ringrit struktura

e Shtatmadhorisë, me në krye nënkolonel Ali Shefqetin. Në nëntor 1920 u caktua ministër Luftë kolonel i Shtatmadhorisë Selaudin Said Shkoza. Në detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor u caktua Ali R. Kolonja, i cili kryente dhe detyrën e komandantit të Divizionit aktiv të Ushtrisë.

Shtatmadhoria varej nga ministri i Luftës. Ajo vlerësohej si një hallkë e rëndësishme për organizim, drejtim, stërvitje dhe planëzim për veprimtarinë e Ushtrisë. Shtatmadhoria ishte racionale në përbërje dhe efektive në veprimtarinë e saj. Kishte në varësi seksione: të mobilizimit, personelit, intendencës, planëzimit etj. Ajo kryente detyra si hartim të projektligjeve, rregullore të shërbimit ushtarak, drejtim të operacioneve ushtarake për ruajtjen e rendit dhe të integritetit territorial të vendit etj.

Hulumtimi i fillesave të shtabit ushtarak shqiptar në këto 110 vjet të jetës së tij, nuk është vetëm një domosdoshmëri historike, por edhe me rëndësi të veçantë në krijimin e kujtesës kombëtare të ushtrisë shqiptare. Shumë nga ëndrrat dhe projektet e ushtarakëve shqiptarë të asaj kohe janë tashmë të mishëruara më së miri në reformat e suksesshme në Forcat e Armatosura shqiptare. Megjithatë, ende sot është mirë që disa prej këtyre traditave të risillen në ushtri, për të theksuar rëndësinë e ushtrisë kombëtare, e cila sot po iu përgjigjet njëkohësisht edhe sfidave të kohës, duke qenë pjesëmarrëse përkrah ushtrive të NATO-s. Nëse të gjithë përpiqemi të bëjmë detyrën tonë si qytetarë e ushtarakë të mirë, atëherë me të vërtetë kemi kryer një detyrim ndaj vetes, familjes dhe kombit. Një komb i ditur dhe me ushtri e shtabe profesionist nuk ka rëndësi se sa i madh është, do të dijë t'u bëjë ballë sfidave e të dalë faqebardhë.





F T E S Ë

Për të gjithë të rinjtë e të rejat, që ta shohin si një mundësi të re për veten, familjen po edhe atdheun, afrimin e tyre me Forcat e Armatosura të Republikës sonë. Pas rritjes së pagave me 30% në vitin 2022 dhe me 7% këtë vit, një tjetër rritje e konsiderueshme deri në 22% do të bëhet realitet në 2024, për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Respekt për punën e vajzave dhe djemve në uniformë, pjesë e vijës së parë të frontit në mbrojtje të territorit të vendit.

Kryeministri Edi Rama

